



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 055

Prishtinë, më 19 dhjetor 2008, në orën 16:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 19 DHJETOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhezair Murati**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 86 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit nga seanca e sotme plenare, me propozimin e Kryeministrit të Kosovës, seanca i zhvillon punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës

Në fillim të seancës lidhur me rendin e ditës diskutuan këta deputetë: Besa Gaxheri, Driton Tali, Gani Geci, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Adem Salihaj, Ibrahim Gashi, Ahmet Isufi, Naser Rugova, Donika Kadaj-Bujupi dhe Shkumbin Demaliaj, të cilët nuk u pajtuan që kjo pikë të shqyrtohet në seancën e sotme, me arsyetimin se ajo ishte hequr nga rendi i ditës i seancës së djeshme.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikës së paraparë.

Kryetari i njoftoi deputetët me raportet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit përgjegjës raportues, që e kanë shqyrtuar Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur rekomandimet e tyre.

Ai hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të deputetit Emrush Xhemajli.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 6.

Kryearti konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale